Policisë Dibër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, referuar kërkesës së autoritetit kontraktor si më sipër cituar, operatori ekonomik “Safe” sh.p.k plotëson kriterin për disponimin nga ana e tij të Qendrës së Kontrollit në Qarkun e Dibër, ku shtrihet objekti i prokurimit të mësipërm, në përputhje me nenin 46 të ligjit të prokurimit publik dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Akoma më tej referuar arsyes së skualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, nga kuptimi literal i pikës 1 të nenit 22 të ligjit nr. 75/2014 datë 10.07.2014, do të thotë se shoqëria e shërbimit privat të sigurisë fizike duhet të disponojë në një nga format ligjore qendër kontrolli në çdo njësi administrative që ushtron veprimtari. Sqarojmë se, qendra e menaxhimit dhe kontrollit, është ambienti me mjete/pajisje që shërben për menaxhimin, kontrollin e veprimtarisë private të sigurisë fizike si dhe zotërimi i saj verifikohet nga Drejtoria e Policisë së Qarkut përkatës dhe pasqyrohet në vërtetimet e lëshuara nga ky institucion i cili monitoron edhe veprimtarinë e SHPSF-ve në njësitë administrative ku ato ushtrojnë aktivitetin e tyre

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik “Safe” sh.p.k. qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Safe” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij me arsyetimin se *“Operatori ekonomik ka sjelle listen e punojsve nga Drejtoria Vendore të Policisë Diber me date 30.07.2019. Operatori Ekonomik ka sjelle keto emra qe jan te licensuar per te ushtruar veprimtarin e sigurise fizike ne qarkun DIBER: Sipas listepagesave te muait Qershor, Korrik. Gusht, Shtator ne listpagesat e shoqerise SAFE dhe qe jane te certifikuar si punojes nga drejtoria e policise diber per ushtrimin e aktivitetit Siguri fizike rezultojne qe te jene te perfshire:*

1. Z Klodian STRAZIMIRI, Fredi KALLAVERJA, jan siguruar me 18 dite pune per muajn Korrik, Gusht dhe shtator ato jan paguar me page 30 400 lek, veprim i cili bie ne kundershtrim me Dispozitat e Kodit te Punes, VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise", si dhe me Deklaraten e OE si ne 4/1 “DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS”.

3. Fatos KURTAGU me nr certifikate 10-1/2019 date 28.09.2018 me kod sigurimesh per siguri private 5419.11 eshte i siguruar me nje page 19.500 i cili eshte i punesuar per nje periudhe prej 11 ditesh ne muaj per muajn Korrik veprim i cili bie ne kundershtrim me Dispozitat e Kodit te Punes VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise", si dhe me Deklaraten e OE si ne 4/1 “DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

4. Ibrahim Kurtaj nuk ka sjelle certifikate dhe nese referohemi listes se punojsve ku esht me certifikat me nr 10-1/19 date 16.03.2015 i ka mbaru afati si dhe nuk ndodhet ne listepagesat e muajt korrik, gusht, shtator.

5. Xhemal AFIZI me nr certifikate 13-1/14 me date 12.11.2018 me kod sigurimesh 8322.07 dhe page minimale 30475 lekë, nuk eshte i siguruar me kodin e sigurise fizike si roje. 5419.11 dhe page minimale 39000 lek sipas Ligjit Nr.75/14 dt.10.07.2014. Veprim i cili bie ne kundershtrim me Dispozitat e Kodit te

Punes VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise", si dhe me Deklaraten e OE si ne 4/1 "DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS.

6. Hasan GJOKA me nr certifikate 9-1/8 me date 18.09.2018 nuk eshte i siguruar me kodin e sigurise fizike si roje. 5419.11 dhe page minimale 39000 lek sipas Ligjit Nr.75/14 dt.10.07.2014 po ashtu per muain korrik rezulton me 9 dite pune ne kundershtim me Dispozitat e Kodit te Punes VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise",si dhe me Deklaraten e OE si ne 4/1 "DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS".

7. Ylli PRENTHI me nr cerifikate 12-1/8 date 31.10.2018 nuk eshte i siguruar 3522.12 dhe page minimale 30500 lek dhe jo me kodin e sigurise fizike si roje 5419.11 dhe page minimale 39000 lek sipas Ligjit Nr.75/14 dt.10.07.2014. VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise",

8. Dashnor KURTI me nr cerifikate 12-1/35 date 31.10.2018 me kod sigurimesh per siguri private 5419.11 eshte i siguruar me nje page 30 400. dhe jo me kodin e sigurise fizike si roje 5419.11 dhe page minimale 39000 lekë sipas Ligjit Nr.75/14 dt.10.07.2014, si dhe eshte ni shkelje te dispozitave te Kodit te Punes, VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise", per shkak se eshte i siguruar me 18 dite pune ne muaj ne kundershtim me Dispozitat e Kodit te Punes si dhe me Deklaraten e OE si ne 4/1 "DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS"

9. Kadri LIKA me nr certifikate 03/2 date 18.06.2018 eshte i siguruar me nje page 30 400 dhe jo me kodin e sigurise fizike si roje 5419.11 dhe page minimale 39000 lek sipas Ligjit Nr.75/14 dt.10.07.2014. po ashtu ai esht epaguar per muain Korrik Gusht Shtatore me 18 dite pune ne kundershtim me Dispozitat e Kodit te Punes VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise",si dhe me Deklaraten e OE si ne 4/1 "DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS".

10. Telat OSMANI me nr certifikate 17-1/17 date 21.02.2019 eshte i siguruar me nje dite pune page 1 600, ne kundershtim me Dispozitat e Kodit te Punes VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise",si dhe me Deklaraten e OE si ne 4/1 "DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS".

11. Vladimir RAMAJ me nr certifikate 19-1/15 date 05.04.2019 me kodin 3522.12 eshte i siguruar me nje page 30 500 dhe jo me kodin e sigurise fizike si roje 5419.11 dhe page minimale 39000 lek sipas Ligjit Nr.75/14 dt.10.07.2014. ne kundershtim me Dispozitat e Kodit te Punes VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise",si dhe me Deklaraten e OE si ne 4/1

“DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS”.

12. Banush TETA me nr certifikate 17-1/13 date 21.02.2019 me kod sigurimes 3513.01 eshte i siguruar me nje page 30 500 dhe jo me kodin e sigurise fizike si roje 5419.11 dhe page minimale 39000 lek sipas Ligjit Nr.75/14 dt.10.07.2014 ne kundershkrim me Dispozitat e Kodit te Punes VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise",si dhe me Deklaraten e OE si ne 4/1 “DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS”.

13. Behar KOLECI me nr certifikate 5-1/6 date 16.07.2018 eshte i siguruar me tre dite pune per muajn Korrik, nje dite pune per muajn Gusht dhe ne muajn shtator nuk figuron ne listen e sigurimeve shoqerore,veprim i cili bie ne kundershkrim me Dispozitat e Kodit te Punes VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise",si dhe me Deklaraten e OE si ne 4/1 “DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS”

14. Ahmet NEZIRI me nr certifikate 12-1/37 date 31.10.2018 eshte i siguruar me nje dite pune per muajn Korrik, nje dite pune per muajn Gusht dhe ne muajn shtator nuk figuron ne liste pagesat e sigurimeve shoqerore. Per muajn Korrik dhe Gusht eshte paguar me page 1600 veprim i cili bie ne kundershkrim me Dispozitat e Kodit te Punes VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise", si dhe me Deklaraten e OE si ne 4/1 “DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS”.

15. Isuf KICA me nr certifikate 19-1/5 date 05.04.2019 eshte i siguruar me nje dite pune per muain Korrik, me nje dite pune per muain Gusht dhe per muain shtatore nuk figuron ne listepagesat e sigurimeve shoqerore, per muain korrik dhe gusht ai eshte paguar me page 1600 veprim i cili bie ne kundershkrim me Dispozitat e Kodit te Punes VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise",si dhe me Deklaraten e OE si ne 4/1 “DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS”.

16. Luan DISHA nuk ka sjelle certifikate dhe nese referohemi listes se punojsve ku esht me certifikat me nr 503 date 02.03.2018 I ka mbaru afati, nuk ndodhet ne listepagesat e sigurimeve Shoqerore per muait Korrik Gusht Shtator.

17. Avenir RAMAJ me nr certifikate 7-1/3 date 04.08.2018 eshte i siguruar me nje dite pune per muajn Korrik, me nje dite pune per muajn Gusht dhe per muajn shtator nuk figuron ne listepagesat e sigurimeve shoqerore, per muain korrik dhe gusht ai eshte paguar me page 1600 veprim i cili bie ne kundershkrim me Dispozitat e Kodit te Punes VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise", si dhe me Deklaraten e OE si ne 4/1 “DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS”.

18. Mentor LUKA me nr certifikate 04/6 date 17.10.2017 eshte i siguruar me nje dite pune per muain Korrik, me nje dite pune per muajn Gusht dhe per muajn shtator nuk figuron ne listepagesat e sigurimeve shoqerore, per muain korrik dhe gusht ai eshte paguar me page 1600 veprim i cili bie ne kundershtrim me Dispozitat e Kodit te Punes VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise",si dhe me Deklaraten e OE si ne 4/1 "DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS"

19. Ylber Rexhep Lleshi me Certifikate Nr. 8-1/23 date 30.08.2018 i cili eshte future ne listen e punonjesve te certifikuar per Qarkun Diber nuk ndodhet ne Listepagesat e Sigurimeve Shoqerore per muain Korrik, Gusht dhe Shtatore te vitit 2019. Po ashtu Belul Femi Dani me Certifikate Nr. 10-1/7. Date 28.09.2018 2018 i cili eshte future ne listen e punonjesve te certifikuar per Qarkun Diber nuk ndodhet ne Listepagesat e Sigurimeve Shoqerore per muain Korrik, Gusht dhe Shtatore te vitit 2019. Xhorxh Hajredin Balja me Certifikate Nr. 12-1/39. Date 31.10.2018 I cili eshte future ne listen e punonjesve te certifikuar per Qarkun Diber nuk ndodhet ne Listepagesat e Sigurimeve Shoqerore per muain Korrik, Gusht dhe Shtatore te vitit 2019. Shukri Nazmi Rruka me Certifikate Nr. 13-1/1. 12.11.2018 i cili eshte future ne listen e punonjesve te certifikuar per Qarkun Diber nuk ndodhet ne Listepagesat e Sigurimeve Shoqerore per muain Korrik, Gusht dhe Shtatore te vitit 2019. Duke u nisur nga sa me siper si dhe nga verifikimet ka rezultuar se per muain Qeshor Operatori Ekonomik permbushin kriteret vetem per 3 tre punojes nga 11 te kerkuar nga ana e autoritetit kontraktor konkretisht, Fatbardh Isaku, Rami Deda dhe Artur Mustafaj. Per muajn Korrik Operatori Ekonomik permbushin kriteret vetem per 3 tre punojes nga 11 te kerkuar nga ana e autoritetit kontraktor konkretisht, Fatbardh Isaku, Rami Deda dhe Artur Mustafaj. Per muain Gusht Operatori Ekonomik permbushin kriteret vetem per 4 kater punojes nga 11 te kerkuar nga ana e autoritetit kontraktor konkretisht, Fatbardh Isaku, Rami Deda, Artur Mustafaj dhe Fastos Kurtaga. Poashtu edhe per muajn shtator. Ne keto kushte KVO vlereson se Operatori Ekonomik nuk permbush nje nga kriteret e vendosura si ne DST Kapaciteti Teknik Pika 3.3: Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 13 (trembedhete) punonjës të siguruar në muaj, 11 (njembedhejte) punonjes sherbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin. Bejn perjashtim rastet kur drejtuesi teknik eshte edhe administrator per kete rast perjashtimore Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 12 (dymbedhejte) punonjës të siguruar në muaj. Si dhe ka vepruar ne Kundershtrim me ate cfar ka deklaruar ne Kriteret e Vecanta te Kualifikimit pika dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 7/1; VKM Nr. 809, date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", piken g, dhe të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014 date 10.07.2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise",. Bazuar ne sa me siper, si dhe ne nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e

nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”. KVO vendos se Operatori Ekonomik nuk permbush te gjitha kerkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktor per tu kualifikuar.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën e 8 “Kriteret e Vecanta për Kualifikim” pika 2.3. “Kapaciteti Teknik” pika 3 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 13 (trembedhete) punonjës të siguruar në muaj, 11 (njembedhete) punonjes sherbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin. Bejn perjashtim rastet kur drejtuesi teknik eshte edhe administrator per kete rast perjashtimore Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 12 (dymbedhete) punonjës të siguruar në muaj.

Ndërsa në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta për Kualifikim” pika 3.1 “Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë” pika 3 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 11 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Perkates;

III.2.2. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Safe” sh.p.k. në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Vërtetim (Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin E-SIG 02/a) Nr. T01446133 datë 09.10.2019, nga ku rezulton me një numër punonjësish mbi 13 për çdo muaj, (për periudhën nëntor 2016-gusht 2019).

Listpagesat për periudhën Janar 2019 – Shtator 2019 të gjeneruara nga Sistemi i online i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

Vërtetim “Për të dhënat e subjektit “Safe” me aktivitet në Qarkun e Dibër nr. 339/1 protokollin datë 25.10.2018 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, bashkëlidhur lista e punonjësve të shoqërisë Private e Sigurisë Fizike SHPSF-së, “Safe” sh.p.k. datë 30.07.2019.

Çertifikata për punonjës shërbimi

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.2.4. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konkretisht në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, *“Kriteret e Vecanta për Kualifikim”*, autoriteti kontraktor, ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 13 (trembedhjetë) punonjës të siguruar në muaj, 11 (njëmbëdhjetë) punonjës shërbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ankimues rezultoi se ky i fundit, ka paraqitur Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit (Qershor, Korrik, Gusht); Listpagesat për periudhën Qershor 2019 – Gusht 2019; si dhe Vërtetim “Për të dhënat e subjektit “Safe” me aktivitet në Qarkun e Dibër nr. 339/1 protokollin datë 25.10.2018 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, bashkëlidhur lista e punonjësve të shoqërisë Private e Sigurisë Fizike SHPSF-së, “Safe” sh.p.k. datë 30.07.2019, çertifikata për punonjës shërbimi të vlefshme; ku konstatohet se ankimuesi ka të pasqyruar në listën e punonjësve të shoqërisë Private e Sigurisë Fizike SHPSF-së, në listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë, si dhe çertifikatat e punonjësve të shërbimit, ashtu siç është kërkuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor. Sqarojmë se periudha për 3(tre) muajt e fundit në kushtet kur detyrimet për kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin kanë afat për tu dorëzuar deri në datën 20 Tetor sipas legjislacionit përkatës tatimor në fuqi, për efekt vlerësimi 3 (tre) muajt e fundit do të konsiderohen muajt Qershor-Korrik-Gusht. KPP më tej gjykon se, formularët e pagave (listpagesat) janë të strukturuar nga administrata tatimore dhe janë keto instanca të cilët janë kompetente për kontrollin dhe monitorimin e pagave dhe formularëve të pagesave, si dhe respektim nga ana e subjekteve tatimore të këtyre dispozitave ligjore. Rjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Safe” sh.p.k. është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit objekt ankimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka përmbushur të gjithë detyrimet ligjore për paraqitjen e listëpagesave për periudhën e kërkuar nga autoriteti kontraktor, çertifikatat për punonjësit e shërbimit, periudhën e kërkuar Qershor 2019 – Gusht 2019 në përputhje

me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor ne dokumntat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përmes dokumentacionit të dorëzuar në S.P.E pala ankimuese ka përmbushur kërkesën e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Safe" sh.p.k. për skualifikimin e operatorëve ekonomikë "Eurogjici" sh.p.k., "Res-03" sh.p.k., "Shpsf Snajper Security" sh.p.k., me arsyetimin se "2 Me dt 25.11.2019 komisioni pe shqyrtimin e ankesave i ngritur per vleresimin e ankeses se paraqitur nga ana jone nuk e ka marre parasysht ankesen tone po me te njejtin argument si ne vleresimin e ofertave qe eshte e pasqyruar me siper , dhe gjithashtu nuk e ka shqyrtuar me korrektesi pasi ne i kemi kerkuar dhe skualifikimin e kompanive Euro-gjici , kevenjo , res-03 , snajper security si oferta nen kosto minimale ligjore si dhe mbajtjen ne skualifikim te kompanive Grand security, internacional security albania, nazeri 2000, ku pervec arsyeve te skualifikimit te gjetura nga kvo-ja tju shtohet dhe arsyeja si oferta nen kosto minimale ligjore.

Duke u nisur nga mosvleresimi i ankeses tone nga komisioni i shqyrtimit te ankesave ne po ju argumentojme dhe arsyen e ofertes tone dhe perse duhet te skualifikohen ofertat e kompanive te siperpermendura si oferta nen kosto minimale ligjore . Per kete arsye ne po ju paraqesim menyren e realizimit te ofertes qe te jeni mete qarte ne vleresim dhe jo si kvo-ja e Ujësjellësit Dibër qe nuk thellohet te vleresoje oferten dhe dokumentat tona duke na bere nje padrejtesi të madhe, dhe ne duke u nisur nga sa thame me lart po ju argumentojme duke u bazuar ne ligjet ne fuqi :

1-Paga minimale ne zbatim te V.K.M. Nr.809, date 26.12.2018 Per Percaktimin e Pages Minimale eshte e detyrueshme te zbatohet nga cdo person, juridik a fizik , vendas ose i huaj,dhe eshte 26.000(njezetegjashtemije) leke.

2-Ne zbatim te Ligjit 75/2014 dt 23.08.2014 Persherbimin privat te sigurise fizike "neni18" Kontrata ndermjet paleve"germa g "paga e punonjesit te rolit haze te sherbimit te jete minimalisht 50 perqind me e madhe se paga minimale e percaktuar me vendimtekeshillit te Ministrave"pra eshte = 39.000 !eke ne muaj

3- Veshitresite (shtesat) per punen e kryer ne tumin II perllogariten ne zbatim te nenit 81 te ligjit nr. 7961 date 12.07.1995 "Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar, ku percaktohet se "puna e kryer nga ora 19.00 - 22.00 jep te drejten e nje shtese mbi page jo me pak se 20 %.

4-Veshitresite (shtesat) per punen e kryer ne tumin III perllogariten ne zbatim te nenit 81 te ligjit nr. 7961 date 12.07.1995 "Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar, ku percaktohet se cdo pune e kryer midis intervalit 22.00 - 06.00 jep te drejten e nje shtese mbi page jo me pak se 50%".

5-Ne zbatim te VKM Nr.1114 dt 30.07.2008 "Per disa ceshtje ne zbatim te ligjit nr.7703 dt l 1.05.l 993"Per Sigurimet shoqerore e shendetsore ne RSH" pjesa qe paguan punedhenesi eshte16.7%.

6- Paga orare referuar legjislacioninit te sipercituar eshte 39.000 !eke /muaj : 174 ore/muaj (K.P) = 224,13leke/ora

7- Nisur nga kërkesa e A.K ku kerkohet ge sherbimi te kryhet per 12 muai dhe viti 2020 eshte vit i brishte me 366 dite referuar nioftimit te KPP date 14.02.2019 si dhe detyrimeve ge parashikohen ne legiislacion oferta ione ekonomike do te iete si me poshte:

8-Meqense kontrata eshte 36 muaj dhe viti 2020 ka 366 dite, ne total jane 1096 dite /36 muaj = 30.44 dite/muaji.

Analiza per 1 roje ne vend roje me 1.66 roje Tueni Ill

- 1.Paga baze= 39.000lekë
2. Shtesa turni 3 - 224.13 lekelora x 50 % x 8 ore x 30. 44: 1. 66roje = 16 439,leke
- 3.sigurimet x 6. 7% = 9258,44/eke
4. Totali per 1 punonjes ne muajpaTVSH = 64 698,24/eke
- 5.Totali per 1 vend ne muaj pa TVSH 64 698,24/eke xl.66 roje = 107 399,07/eke

Analiza per 1 roje ne vend roje me 4.98 roje 24 oreshe

- 1.Paga baze = 39.000 lekë
 2. Shtesa turni 2 - 224.13 leke/ora x 20 % x 3 ore x 30.44 :4. 98roje = 821.99 lekë
 - 3.Shtesa turni 3 - 224.13 lekelora x 50 %x 8 ore x 30.44 :4.98roje = 5479,93lekë
 4. sigurimet x 6. 7% = 7.565,42 lekë
 5. Totali per 1 punonjes ne muaj paTVSH = 52.867,34 lekë
 6. Totali per 1 vend ne muaj pa TVSH 52.867,34/eke x4. 98roje = 263.279,35 lekë [...] ”
- Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.3.2. Neni 56 i LPP përcakton shprehimisht se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve ose shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve punë shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.3.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 5, përcaktohet se: “- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlogaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.3.4. Referuar nenin 56 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin përfundimtar për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në rast se një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta.

Pra, autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomik – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalisht të ulët pas përlogaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentat standart të tenderit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave të një autoriteti kontraktor, në rastin e procedurës së prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të njëjtin detyrim ligjor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pra verifikon ofertat që plotësojnë kriteret kualifikuese, e më pas, nuk rezultojnë të jenë anomalisht të ulëta.

III.3.5. Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 56 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të papërgjegjshme, duke kryer përlogaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalisht të ulëta.

Edhe në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e argumentimit dhe shpjegimit të kësaj oferte nga ana e operatorit ekonomik ankimes duke e dokumentuar, argumentuar me prova shkresore sqarimet për elementin apo elementët e veçantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Në rast se një ofertë ekonomike, autoritetit kontraktor do t'i rezultojë anomalisht e ulët, atëherë, legjislacioni për prokurimin publik ka përcaktuar mënyrën se si ky i fundit mund të mbrohet nga një ofertë e tillë dhe konkretisht duke i kërkuar operatorit ekonomik, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar sa më sipër, një autoritet kontraktor ashtu siç vepron në çdo procedurë prokurimi, edhe në rastin e procedurës për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të drejtë që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të zbatojë parashikimin ligjor në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në rast se një ofertë rezulton e tillë.

III.3.6. Nga ana tjetër, në rastin e procedurave të prokurimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, nëse një autoritet kontraktor, për shkak edhe të vetë specifikës dhe veçantisë së këtij shërbimi, bazuar në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, ka kërkuar preventive apo analizë kosto, duke përfshirë në të gjithë elementët ligjorë që përbëjnë një kosto ditore duke detajuar zërat apo elementët e veçantë të kësaj kosto, mbi bazën e të cilave autoriteti kontraktor do të gjykojë ofertën e paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se do të qëndrojë strikt vendimit të autoritetit kontraktor, mbi bazën e të cilit do të gjykojë më pas, si në rastin kur ka kryer vlerësimin e ofertave duke konkluduar mbi ofertën totale, ashtu edhe në rastin kur ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto dhe ka bërë vlerësimin e ofertave duke shqyrtuar secilin zë apo element të veçantë të ofertës.

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik, argumenton se ky qëndrim i tij bazohet në qëllimet e ligjit të prokurimit publik për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale; sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rast se autoritetet kontraktore do të veprojnë në kundërshtim me sa më sipër, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik do t'i rishikojë administrativisht duke i gjykuar ato si të gabuara.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtëpërdrejtë i shërbimit të kërkuar (në këtë rast shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike), është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas

legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet se: “1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo njësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.

2. Ofertuesit ose kandidatit mund t’i kërkohet të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”.

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, ashtu siç edhe në rastin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike që një element kryesor është paga minimale, e cila në rastet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto apo kur oferta nuk konstatohet të rezultojë anomalisht e ulët, nuk ka pse të jetë objekt kontrolli edhe nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me pagën minimale të punonjësve në shkallë vendi.

Në rast se ofertat e kualifikuara nuk rezultojnë anomalisht të ulëta, pas përlllogaritjeve përkatëse, apo në rast se rezultojnë të tilla dhe nga autoriteti kontraktor nuk evidentohen shkelje të atij karakteri që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, të tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, si qëllim parësor të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por bindet me provat dhe argumentat e paraqitura nga operatori ekonomik, atëherë, autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

III.3.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, të modifikuara në Shtojcën 1 “*Formulari i ofertës*”, autoriteti kontraktor ndër te tjera ka përcaktuar:

Shtojca 1

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik*]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
|---|--------------------------|--|-------------|-------------|---------|
| Nr | Sasia (nr.vendrojeve) | Numri total i rojeve për vendroje | Çmimi Njësi | Çmimi Total | Afati |
| Ruajtje objekti e Ujesjelles Kanalizimi Diber me roje private, Depo me vendndodhje Lagja Kamen Peshkopi Diber. Turni I-II-III | 1 | 4.98 | | | 36 Muaj |
| Ruajtje objekti e Ujesjelles Kanalizimi Diber me roje private, Depo II, me vendndodhje Lagja Kallavere Peshkopi Diber. Turni I-II-III | 1 | 4.98 | | | 36 Muaj |

| | | | | | |
|--|----------|-------------|--|--|----------------|
| <i>Ruajtje objekti e Ujesjelles Kanalizimi Diber me roje private, Zyra me vendndodhje, Rruga “ Ismail Feta” lagjia “ Treg”</i> | <i>1</i> | <i>1.66</i> | | | <i>36 Muaj</i> |
| <i>Peshkopi, Diber. Turni- III</i> | | | | | |
| <i>Çmimi Neto)</i> | | | | | |
| <i>TVSH (%)</i> | | | | | |
| <i>Çmimi Total</i> | | | | | |

III.3.9. Në Shtojcën 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 7 e dokumentave të tenderit, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin analizen e koston per oferten e paraqitur. (Shih Shtojca 1 - Sqarime).

III.3.10. Në rastin në fjalë, Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar shprehimisht në dokumentat standarte të tenderit që operatori ekonomik duhet të shoqërojë formularin e çmimit të ofertës me analizën e koston te detajuar për ofertën e paraqitur, por nga verifikimi i dokumentave standarte të tenderit rezulton se analiza koston nuk i është bashkangjitur shtojcës 1 “Formularit të Ofertës”, duke mos përcaktuar në këtë mënyrë se si do ofrohet, në kosto ditore, kosto mujore apo në kosto në total, si dhe nuk është përcaktuar nëse në analizën e koston rrjedhimisht dhe në ofertë do të përfshihen të gjitha shpenzimet dhe detyrimet fiskale të parashikuara në ligjore. Komisioni, në vijimësi, është shprehur se autoritetet kontraktore janë në të drejtën e tyre të kërkojnë preventivin/analizën e koston duke përfshirë në të, të gjithë elementët e parashikuar nga ligji dhe, në bazë të tyre të gjykojnë ofertat e paraqitura duke përzgjedhur ofertën më të mirë e që garanton një kontratë të suksesshme. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor ka përcaktuar vetëm “Formularin e Ofertës” shtojca 1 pa dhënë detaje në lidhje me plotësimin e ofertës/preventivit, për kosto ditore/mujore dhe duke mos e publikuar këtë shtojcë sipas formatit të miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik për

procedurat e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, gjë kjo e cila shkakton konfuzion si tek operatorët ekonomikë ashtu edhe tek komisioni i shqyrtimit të ankesave.

Sa më sipër KPP gjykon se, dokumentat e tenderit duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e shërbimeve, si dhe kërkesave të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e shërbimit të ruajtjes me roje, (pra të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar).

Mungesa e elementëve të sipërcituar shërben si pengesë për konkurrencën dhe vlerësimin e drejtë në prokurimin publik, në kundërshtim me parimet e përgjithshme të prokurimit publik të përcaktuara në nenin 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ndaj Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kjo procedurë prokurimi duhet të anulohet, pasi në rastin konkret ndodhemi në kushtet e parashikuara në nenin 64, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: ... b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj.”

Për sa më sipër analizuar, duke qenë se veprimet e autoritetit kontraktor kanë shërbyer si pengesë për konkurrencën e drejtë, si dhe kanë krijuar konfuzion tek operatorët ekonomikë të cilët në paraqitjen e ofertës ekonomike janë bazuar tek kriteret e kualifikimit ndërkohë që autoriteti në shkelje të ligjit ka shmangur vlerësimin e ofertave në bazë të kriterëve kualifikuese në kundërshtim me parimet e përgjithshme të prokurimit publik të përcaktuara në nenin 2 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kjo procedurë prokurimi duhet të anulohet, pasi në rastin konkret ndodhemi në kushtet e parashikuara në nenin 64, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: ... b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj.”*

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpallje të saj duhet të përcaktojë qartë informacionin dhe kriteret lidhur me sa konstatuar më lart, e si rrjedhim pretendimet e operatorit ekonomik ankimes nuk do të merren në shqyrtim.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Safe” sh.p.k., mbi shoqëritë e tjera pjesëmarrëse, referuar arsyetimit në Pikën III.3.10., në kushtet kur kjo procedurë prokurimi shkon drejt anulimit, KPP gjykon se pretendimet e ankimesit nuk do të merren në shqyrtim.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik “Safe” sh.p.k. mbi shoqëritë e tjera nuk do të merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.

596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik “Safe” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-34572-08-29-2019, me objekt “Shërbimi i Ruajtjes dhe sigurisë fizike të ambjenteve në administrimin e SH.A. Ujësjetës –Kanalizime Dibër”, me fond limit 22.826.998 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.10.2019 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Dibër.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe në rishpalljen e saj të korrigjojë shkeljet e konstatuara nga Komisioni i Prokurimit Publik sipas arsytimit të mësipërme.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Safe” sh.p.k..
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1831 Protokoli

Datë 03.12.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

| | | | |
|----------------------|---------------------|----------------------|---------------------|
| Nënkryetar | Anëtar | Anëtar | Anëtar |
| Enkeleda Bega | Vilma Zhupaj | Lindita Skeja | Merita Zeqaj |

Kryetar
Evis Shurdha